



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 36

Datë: 28. 11. 2022. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raport për Aktivitetet e ZRCKFSP

-Rekomandim për certifikimin e kandidateve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovice e Veriut

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në: Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

4. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

2. Kreshnik Radoniqi: E hapi mbledhjen e 36-të me këtë rend dite që e keni përpara. Mungon Rifati, ndërsa Samiu besoj që na bashkangjiten me kohë... Kush është për këtë rend dite...?

Me 8 vota për, miratohet rendi i ditës.

3. Raport për Aktivitetet e ZRCKFSP

Rekomandim për certifikimin e kandidatëve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Vesa Xharra: Në përputhje me planin operacional të miratuar nga KQZ për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriu, Zyra ka pritur aplikimet për certifikim nga subjektet politike deri më datën 25 nëntor 2022, deri në ora 16:00.

Të gjitha aplikimet për certifikim për pjesëmarrje në këto Zgjedhje, janë kontrolluar dhe verifikuar nga Zyra nëse plotësojnë të gjitha kriteret e parapara në me Ligjin për Zgjedhjet Përgjithshme në Kosovë më saktësisht neni 15 si dhe nenet 3 dhe 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe kandidatëve. Në përputhje me afatet e përcaktuara në planin operacional, Zyra gjithashtu ka bërë verifikimet e dyfishta të kandidatëve ku është bërë verifikimi i kandidatëve në bazë të të dhënave në listën votuese dhe rezulton se të gjithë kandidatët janë votues në komunat në të cilat garojnë. Gjithashtu janë bërë verifikimet e nevojshme në institucionet relevant, në përputhje me obligimet që dalin nga neni 29 i LZP.

Në vazhdim të raportit të zyrës, Xharra paraqiti rekomandimet për certifikim të subjekteve politike, dhe të kandidatëve si në vazhdim. Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimet, si në vijim:

1. Subjekti politik **Iniciativa Qytetare Mitrovica**, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjektit politik me datën 18 nëntor 2022. Ky subjekt politik ka aplikuar për tu certifikuar për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut. Pas kontrollimit të dokumentacionit, Zyra ka vërtetuar që ky subjekt politik ka plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandon certifikimin e subjektit politik dhe kandidatit të këtij subjekti politik **Betim Osmani** për Kryetar komune në Mitrovicë të Veriut.

Me 9 vota për, miratohet.

2. Partia politike **Partia Demokratike e Kosovës**, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjektit politik me datën 21 nëntor 2022. Kjo parti politike ka aplikuar për tu certifikuar për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Pas kontrollimit të dokumentacionit, Zyra ka vërtetuar që ky subjekt politik ka plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandon certifikimin e kandidatëve të kësaj partie politike si në vijim:

Albulena Behluli Hetemi, kandidate për Kryetare të komunës në Leposaviq,

Izmir Zeqiri, kandidat për Kryetar komune në Zubin Potok,

Ilir Peci, kandidat për Kryetar komune në Zveçan,

Taulant Kelmendi, kandidat për Kryetar komune në Mitrovicë të Veriut.

Me 9 vota për, miratohet subjekti dhe kandidatët.

- Partia politike **Partija Kosovskih Srba**, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjektit politik me datën 21 nëntor 2022. Kjo parti politike ka aplikuar për tu certifikuar për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq. Pas kontrollimit të dokumentacionit, Zyra ka vërtetuar që ky subjekt politik ka plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandon certifikimin e kandidatit të kësaj partie politike **Aleksandar Jablanović** për Kryetar komune në Leposaviq.

Miratohet, me 9 vota për miratohet subjekti, dhe kandidati.

- Partia politike **Lëvizja Vetëvendosje**, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjektit politik me datën 25 nëntor 2022. Kjo parti politike ka aplikuar për tu certifikuar për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Pas kontrollimit të dokumentacionit, Zyra ka vërtetuar që ky subjekt politik ka plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandon certifikimin e kandidatëve të kësaj partie politike si në vijim:

Lulzim Hetemi, kandidat për Kryetar komune në Leposaviq,

Flatron Hasani, kandidat për Kryetar komune në Zubin Potok,

Fetah Peci, kandidat për Kryetar komune në Zveçan,

Erden Atiq, kandidat për Kryetar komune në Mitrovicë të Veriut.

Me 9 vota për, miratohet subjekti dhe kandidatët.

- Subjekti politik **Građanska Inicijativa Srpski Opstanak**, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjektit politik me datën 25 nëntor 2022. Ky subjekt politik, ka aplikuar për tu certifikuar për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut. Pas kontrollimit të dokumentacionit, Zyra ka vërtetuar që ky subjekt politik ka plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandon certifikimin e subjektit politik dhe kandidatit të këtij subjekti politik **Aleksandar Arsenijović** për Kryetar komune në Mitrovicë të Veriut.

Me 9 vota për, miratohet subjekti dhe kandidati i këtij subjekti.

- Kandidatja e pavarur **Sladjana Pantović**, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të me datën 25 nëntor 2022. Kandidatja e pavarur ka aplikuar për tu certifikuar për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Zveçan. Pas kontrollimit të dokumentacionit, Zyra ka

vërtetuar që ka plotësuar kërkesat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandon certifikimin e kandidatës së pavarur **Sladjana Pantović** për Kryetare të komunës në Zveçan.

Me 9 vota për, miratohet subjekti politik dhe kandidatja e këtij subjekti.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në: Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka mbajtur takimin dhe ka shqyrtuar rekomandimet e Sekretariatit. Subjektet politike që kanë nominuar anëtarët e tyre për KKZ-të pas verifikime të bëra, dhe në përputhje me ligjin për zgjedhjet në bazë të nenit 67, është rekomanduar i njëjti në KOZ dhe, është dhënë rekomandimi që komisionet komunale të plotësohen edhe me antërë të organizatave civile dhe me ish anëtarë dhe me ish anëtarë të komisioneve të kalura zgjedhore. Kështu, meqë të nominuarit janë kryesisht nga subjektet shqiptare, në Leposaviq kemi 4 nominime, në Zubin Potok kemi 3 nominime, në Zveçan 4 nominime, dhe në Mitrovicën e veriut kemi 5 nominime. Ne, rekomandojmë për aprovim...

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për miratohen këto nominime.

Meqë, tani këto i kemi të nominuar këto komisione, atëherë realisht duhet të sigurohen edhe hapësirat brenda komunave që të zhvillohet i gjithë procesi operacional...Pra, kërkohet të kenë qasje në zyrat e zyrtarëve tanë që i kemi në këto komuna...

Insistoj që, të kemi komunikim dhe të plotësohen këto kushte...! Pra, që ne të zhvillojmë aktivitetet tona sipas planit...

Ilir Gashi, tha se nuk është e tepërt që të themi se, ne i nominuam komisionet por ende nuk e kemi të qartë se si do të veprojmë ne në ditën e zgjedhjeve...! Nuk e di nëse nga mbledhja e fundit e deri tani, janë vënë kontaktet me institucionet, dhe si shihet, si do të jetë qasja...? Cila, është alternativa...? Pa humbur kohë, duhet të kishim një plan operacional të sigurisë...? Kryesues, është mirë që në mbledhjen e radhës të kemi si KQZ, përgjigjet e organeve të sigurisë...

Kreshnik Radoniqi: E kemi dërguar shkresën, por ende nuk kemi përgjigje...! Nëse, nuk do të kemi së shpejti përgjigje, ne duhet të kërkojmë takim...

Sami Hamiti: Është një memorandum që është në fuqi, tash jemi në situatë kur i certifikuam kandidatët dhe komisionet...

Në obligimet që i ka policia në memorandum që është në fuqi dhe i nënshkruam, thuhet se:

“Policia angazhohet për siguri dhe përcjellje të materialit sensitiv, kontrollim antiterrorist paraprak të lokacioneve që përfshinë komisionet komunale, dhe merret edhe me sigurimin fizik të tyre të pandërprerë...”. Do të thotë, e ka obligim kështu që nga sot ato KKZ janë votue, dhe duhet dërgua emrat në polici, dhe ata me i hap ato zyre dhe policia me i sigurua...! Po ashtu, edhe Prokurori i Shtetit të përcaktoj prokurorët e këtyre komunave... Pra, besoj që kjo është urgjente...Menjëherë t’u shkruhet...

Alim Rama, tha se ndan shqetësimin por, në Sekretariat të përfundohen të gjitha procedurat... Si KQZ duhet të fokusohemi në punët tona...Të plotësohen KKZ-të...të kontaktohen partitë dhe iniciativat që të nominojnë anëtarët e tyre...

Para se të shkojmë të institucionet tjera, të fokusohemi njëherë në punët tona...! Nuk e pash raportin, ndoshta jam vonuar... Njëherit, në fund, të gjithave ju uroj festën e Flamurit...

Čemailj Kurtiši: Së pari, ju uroj zyrtarisht festën, e dyta, kemi zgjedhje të jashtëzakonshme por kemi edhe situatë të jashtëzakonshme. Të gjithë, ta kuptojmë deri në fund këtë dhe me intensitet të shquar që të gjithë ti kuptojnë punët e tyre. Të gjithë të jenë në vendin e tyre, dhe të mos na ndodh diçka që të mos vijmë në situatë të padëshiruar...që, do ti dëmtonte zgjedhjet...

Sami Hamiti, tha se po KQZ duhet ti kryej punët e veta ! Por, ne me dhunë s'mund ti shtyjmë subjektet që ti bëjnë nominimet e tyre... Por, ne e kemi atë memorandum, dhe të gjitha institucionet ti marrin përgjegjësitë e veta...Ne t'onën, ata tyre...!

Kreshnik Radoniqi: I kemi dërguar shkresat, i dërgojmë prapë...!

5. Të ndryshme !